



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr.18, datë 28.05.2020

**Për miratimin e “Rregullores për trajtimin e ankesave
në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave,
në rast ngjarjeje sigurimi”**

Në mbështetje të nenit 15, pika 3, të nenit 38, pika 12, 13 dhe 14, nenit 39, pika 15 dhe nenit 52, pika 1, shkronja “dh” të Ligjit nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 20 të Rregullores “Për kompensimin e depozitave të siguruar” të miratuar me Urdhër të Guvernatorit nr. 3762, datë 18.7.2016, të nenit 23, nenit 44, nenit 58, nenit 82, nenit 98 dhe 99 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015, të nenit 7 pika 4 dhe pika 6, të nenit 8, pika 2, shkronja “k” të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 8, pika 3, shkronja “j”, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Rregulloren për trajtimin e ankesave në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave në rast ngjarjeje sigurimi”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha njësitë organizative të Agjencisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar